

SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME KORÇË SH.A.

Nr. _____ Prot

Korçë më, 20.04.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

“Rinovimi i sistemeve elektrike, i automatizimit dhe i sistemeve SCADA, për Stacionin e Pompave Turan”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 31155000-7 Inverter; 31174000-6 Transformatorë furnizimi me energji elektrike; 35711000-1 Sisteme komandimi, kontrolli dhe komunikimi; 42122430-3 Pompa centrifugale; 45311000-0 Instalime elektrike dhe montim; 45317200-4 Instalime elektrike të transformatorëve.

VLERA E FONDIT LIMIT:

183 240 035,41 (njëqind e tetëdhjetë e tre milion e dyqind e dyzet mijë e tridhjetë e pesë presje dyzet e një) leke pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontraktor Shoqëria Aksionare Ujësja e Kanalizimeve Korçë Sh.A (UKKO SH.A.) ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3 ,me vlerë 3 664 800 (tremilion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katë mijë e tetëqind) lekë (2% të vlerës së përlllogaritur të kontratës).

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8.

K. Dishnica

R. Rrezhda

V. Lubonja

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 183.240.035,41 lekë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet bazuar në dispozitat e sipërpërmendura ku përcaktohet: Autoriteti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave **të xhiros vjetore** të realizuar nga operatori ekonomik dhe sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, **për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.** Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) **vlerën e përlllogaritur të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.**

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare **konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.**

Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Ajo i shërben UKRK Sh.A , për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 61, të Ligjit Nr. 29, dt. 30.03.2023 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet: Çdo person që i nënshtrohet këtij ligji është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfardo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.

2.1.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2023, 2024, 2025 të paraqitura në organet tatimore dhe të konfirmuara nga ana e këtyre organeve, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse bilancet janë në përputhje me parashikimet e nenit 43/4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar, **ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare **konsiderohet e përmbushur nëse bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.**

K. Dishnica

R. Rrezhda

V. Lubonja

Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.2 Kapaciteti teknik:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm, në një vlerë jo më të vogël se 91 620 000 lekë pa TVSH dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;
- b) punë të ngjashme, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se 366.480.070 lekë pa TVSH.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

Për kontrata të realizuara me ente publike operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
- Kontratë Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Aktin e kolaudimit;

Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm :

- Vërtetim për kryerjen me sukses të kontratës, (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
- Kontratë Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Fatura tatimore përkatëse, të deklaruara në organet tatimore

R. Rrezhda

V. Lubonja

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, ofertuesi, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE.

(Shënim: të përcaktohen dokumentet konkrete që kërkohen për të dëshmuar përvojën e mëparshme të ngjashme me sektorin privat, apo me ente publike të cilat janë të nevojshme dhe i shërbejnë AK për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme **të jenë minimalisht në vlerat 50% të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose të jenë minimalisht sa dyfishi i vlerës limit të kontratës** që prokurohet, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerat si më sipër, që janë brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosija e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor UKRK SH.A., për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përpjesëtim me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës siç është parashikuar nga AK.

Shënim: (Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi).

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. të ndryshuar, **ose licencën profesionale të ekuivalentuar në Shqipëri për operatorët e huaj**, në përputhje me zërat e punimeve që përfshihen në preventivin e punimeve, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit :

- NP-11 A – Ndertime per N/staione, kabinat e transformatoreve linja e TN te mesem dhe shperndarjen e energjise

R. Rrezhda

V. Lubonja

Për punimet special të ndërtimit:

- NS-13 A – Impiante dhe linja telefonike dhe telekomunikacioni
- NS-14 A – Impiante te brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.

(Shënim: përcaktoni kategoritë e nevojshme të licencës, me emërtimin e tyre në përputhje me legjislacionin e fushës, duke përcaktuar edhe nivelin minimal të klasifikimit për çdo kategori, sipas vlerave të punimeve konkrete që do kryhen, si dhe institucionin që lëshon këtë licencë).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar., nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar., si dhe VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 ”Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike , që ushtrojnë veprimtari ndërtimi.”, i ndryshuar.

(Shënim: përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor që parashikon licencimin në fushën e zbatimit të punimeve të ndërtimit, kategoritë e nevojshme të licencës, me emërtimin e tyre në përputhje me legjislacionin e fushës, duke përcaktuar edhe nivelin minimal të klasifikimit për çdo kategori, sipas vlerave të punimeve konkrete që do kryhen, si dhe institucionin që lëshon këtë licencë).

Kriteri lidhur me kategorinë e licencave profesionale , në fushën e zbatimit në ndërtim, nivelet e klasifikimit të kategorive janë në përputhje me natyrën e kontratës dhe në përpjestim me volumet e punimeve.

Vendosja e këtij kriteri, që ndikon drejtpërsëdrejti në pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë , bazohet në:

- a. Tipologjinë e objektit të kontratës që prokurohet dhe vlerën limit të parashikuar;
- b. Zërat e punimeve të parashikuara në preventivin e objektit, volumet e tyre dhe vlerat e parashikuara në secilin prej tyre në hartimin e fondit limit;
- c. Përshkrimin e veprimtarive konkrete të parashikuara për t’u realizuar në specififikimet teknike;
- d. Kategoritë e punimeve të zbatimit në ndërtim, përshkrimin e secilës prej tyre dhe vlerat në lekë që i përkasin klasifikimeve të specifikuara në VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 ”Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike , që ushtrojnë veprimtari ndërtimi.”, i ndryshuar;

Për :

- NP-11 A – Ndertime per N/staione, kabinat e transformatoreve linja e TN te mesem dhe shperndarjen e energjise

- NS-13 A – Impiante dhe linja telefonike dhe telekomunikacioni

R. Rrezhda

V. Lubonja

- NS-14 A – Impiante te brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.

Niveli i klasifikimit korespondues është niveli “A”, i cili është për vlerë pune 0-20 milion Lekë.

Shpjegime për kategoritë e punimeve të zbatimit në ndërtim:

NP-11 – Ndertime per N/staione, kabinat e transformatoreve linja e TN te mesem dhe shperndarjen e energjise

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshëm për shpërndarjen e T/N dhe tensionit të mesëm dhe për transformimin dhe shpërndarjen e tensionit të ulët deri te përdoruesit e energjisë elektrike, të kompletuar me punimet e muraturës, plotësuese ose ndihmëse, të veçanta ose të rrjetit. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar centrale dhe kabina transformacioni, shtyllat metalike të nevojshme për transportin dhe shpërndarjen e çfarëdo lloj tensioni, furnizimin dhe vendosjen në vepër të linjave elektrike për çfarëdo numër fazash elektrike, ajrore ose tokësore.

NS-13 – Impiante dhe linja telefonike dhe telekomunikacioni

Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave telefonike të jashtme dhe impiante të telekomunikacionit me frekuencë të lartë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të kompletuara me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për tu realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

NS-14 – Impiante te brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.

Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të transmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t’u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-11 A	Ndertime per N/staione, kabinat e transformatoreve linja e TN te mesem dhe	Çmontimi i te gjitha elementeve te cilet do te zevendesohen sipas pershkrimitne dokumentin	0-20ml leke	16,254,123.09

	<p>shperndarjen e energjise</p>	<p>RELACION TEKNIK I PROJEKTIT dhe largimi i tyre ne vendin qe do te caktohet nga UKRK Sh.a. F.V. e kabllit 1x185 mm² XLPE nga ndaresi i OSHEE tek Ndaresi Hyres, INCOMIN FROM NETWORK, duke perfshire punimet ndihmese per shtrimin e tij ne kanal sipas specifikimeve F.V. e kabllit 1x185 mm² XLPE nga ndaresi i OSHEE tek EMG, duke perfshire punimet ndihmese per shtrimin e tij ne kanal sipas specifikimeve F.V. e koka kabllit per kabllin 185 mm² XLPE F.V. kabell 1x185 mm² nga Ndaresat e TM te Transformoret perkates sipas skemes, ne kanalinat ekzistuese F.V. e koka kabllit per kabllin 185 mm² XLPE per pozicionin 1.4 "V. FILTER UNIT, Shina kryesore (In main bus bar): 630 A, Shina dytesore (In shunt bus bar): 630 A, Izolator: SM6, Pajisja e kontrollit te izolatorit: CS1, Nderpreresi: Mollar Type Contactor, Transformoret e rrymes: 425, Transformoret e tensionit: ARMS/111 75/5 A, Toroidali:CSH120 Mbrojtja: Easergy PSU20–AABB–IAGGA–BAE, Siguersat: 24 V DC 100 A" V. FILTER UNIT, Shina kryesore (In main bus bar): 630 A, Shina dytesore (In shunt bus bar): 630 A, Izolator: SM6, Pajisja e kontrollit te izolatorit: CS1,</p>		
--	--	---	--	--

		<p>Ndërprerësi: Mollar Type Contactor, Transformatorët e rrymës: 425, Transformatorët e tensionit: ARMS/111 50/5A, Toroidali: CSH120, Mbrojtja: Easergy PSU20–AABB–IAGGA–BAE, Siguresat: 24 V DC 100 A</p> <p>V. TURANI DIST. TRANSF. Shina kryesore (In main bus bar): 630 A, Shina dytësore (In shunt bus bar): 630 A, Izolator: SM6, Pajisja e kontrollit të izolatorit: CS1,</p> <p>Ndërprerësi: Mollar Type Contactor, Transformatorët e rrymës: 425, Transformatorët e tensionit: ARMS/111 50/5A A, Toroidali: CSH120, Mbrojtja: Easergy PSU20–AABB–IAGGA–BAE, Siguresat: 24 V DC 100 A</p> <p>V. SPARE, Shina kryesore (In main bus bar): 630 A, Shina dytësore (In shunt bus bar): 630 A, Izolator: SM6, Pajisja e kontrollit të izolatorit: CS1,</p> <p>Ndërprerësi: Mollar Type Contactor, Transformatorët e rrymës: 425, Transformatorët e tensionit: ARMS/111 75/5 A, Toroidali: CSH120, Mbrojtja: Easergy PSU20–AABB–IAGGA–BAE, Siguresat: 24 V DC 100 A,</p> <p>Fuqia kVA: V. TPS 1.1 MOTOR FEEDER, Shina kryesore: 630 A, Shina dytësore: 630 A, Izolatori: SM6, Pajisja e kontrollit të izolatorit: CS1,</p> <p>Ndërprerësi: Rollarc R400 kontaktor, Transformatorët e rrymës: 20 kV, 125 A / 250 A, DC 48 V, Transformatorët e tensionit: ARMS/111, Toroidali: 75/5 A, Mbrojtja:</p>		
--	--	---	--	--

		<p>CSH120, Siguresat: Easergy PSU20–AABB–IAGGA–BAE, Fuqia kVA: 24 V DC, 100 A, Ngarkesa: 700 V. TPS 1.2 MOTOR FEEDERE, Shina kryesore: 630 A, Shina dytësore: 630 A, Izolatori: SM6, Pajisja e kontrollit të izolatorit: CS1, Ndërprerësi: Rollarc R400 kontaktor, Transformatorët e rrymës: 20 kV, 125 A / 250 A, DC 48 V, Transformatorët e tensionit: ARMS/111, Toroidali: 75/5 A, Mbrojtja: CSH120, Siguresat: Easergy PSU20–AABB–IAGGA–BAE, Fuqia kVA: 24 V DC, 100 A, Ngarkesa: 700 V. TPS 2.1 MOTOR FEEDER, Shina kryesore: 630 A, Shina dytësore: 630 A, Izolatori: SM6, Pajisja e kontrollit të izolatorit: CS1, Ndërprerësi: Rollarc R400 kontaktor, Transformatorët e rrymës: 20 kV, 125 A / 250 A, DC 48 V, Transformatorët e tensionit: ARMS/111, Toroidali: 75/5 A, Mbrojtja: CSH120, Siguresat: Easergy PSU20–AABB–IAGGA–BAE, Fuqia kVA: 24 V DC, 100 A, Ngarkesa: 700 V. TPS 2.2 MOTOR FEEDER, Shina kryesore: 630 A, Shina dytësore: 630 A, Izolatori: SM6, Pajisja e kontrollit të izolatorit: CS1, Ndërprerësi: Rollarc R400 kontaktor, Transformatorët e rrymës: 20 kV, 125 A / 250 A, DC 48 V, Transformatorët e tensionit: ARMS/111, Toroidali: 75/5 A, Mbrojtja: CSH120, Siguresat: Easergy PSU20–AABB–IAGGA–</p>		
--	--	--	--	--

		<p>BAE, Fuqia kVA: 24 V DC, 100 A, Ngarkesa: 700</p> <p>V. INCOMING FROM EMG, IN MAIN BUS BAR :630 A, IN SHUNT BUS BAR : 630 A, ISOLATOR IMS: SM6, ISOLATOR CONTROL DEVICE: CS1, BREAKER : SF1 20 kV – 12.5 kA – 250 A M = BA – BC MIN 24 VDC, CURRENT TRANSFORMERS: ARM3 / N2f 200 / 5 – 5 A, VOLTAGE TRANSFORMERS : VRQ2 / S2 20 kV : $\sqrt{3}$ V / 100 : $\sqrt{3}$ V / 100 : 3 V, TOROIDAL :CSH120, PROTECTION : Easergy P5F30 - AACB - IBBA - BAEA, FUSES: POWER kVA :1000 kVA</p> <p>V. INCOMING FROM METRING, IN MAIN BUS BAR :630 A, IN SHUNT BUS BAR : 630 A, ISOLATOR IMS: SM6, ISOLATOR CONTROL DEVICE: CS1, BREAKER : SF1 20 kV – 12.5 kA – 250 A M = BA – BC MIN 24 VDC, CURRENT TRANSFORMERS: ARM3 / N2f 200 / 5 – 5 A, VOLTAGE TRANSFORMERS : VRQ2 / S2 20 kV : $\sqrt{3}$ V / 100 : $\sqrt{3}$ V / 100 : 3 V, TOROIDAL :CSH120, PROTECTION : Easergy P5F30 - AACB - IBBA - BAEA, FUSES : POWER kVA :1000 kVA</p> <p>V. METRING, IN MAIN BUS BAR :630 A, IN SHUNT BUS BAR : 630 A, ISOLATOR IMS: SM6, ISOLATOR CONTROL</p>		
--	--	--	--	--

		<p>DEVICE: CS1, BREAKER : SF1 20 kV – 12.5 kA – 250 A M = BA – BC MIN 24 VDC, CURRENT TRANSFORMERS: ARM3 / N2f 200 / 5 – 5 A, VOLTAGE TRANSFORMERS : VRQ2 / S2 20 kV : $\sqrt{3}$ V / 100 : $\sqrt{3}$ 3 V / 100 : 3 V, TOROIDAL :CSH120, PROTECTION : Easergy P5F30 - AACB - IBBAA - BAEA, FUSES:POWER kVA :1000 kVA V. INCOMING FROM NETWORK, IN MAIN BUS BAR :630 A, IN SHUNT BUS BAR : 630 A V. Banko baterish 48 V DC me furnizim 220 V kapaciteti 10 kVA Trn-03-00-02 V. Transformator fuqie me vaj 20/10/0.4 kV 400 kVA Vcc = 7% Trn-03-00-02, V. Transformator TPS1 fuqie me vaj 20/10/0.69 kV 800kVA Vcc = 7% Trn-03-00-02 V. Transformator TPS2 fuqie me vaj 20/10/0.69 kV 400 kVA Vcc = 7% Trn-00-00-03 V. Transformator EMG fuqie ne te thate 20/10/0.4 kV 1000 kVA Vcc = 6% V. Low Harmonic VFD Drive 600 kW, 690 V; Tension furnizimi 690 V, 3~ 50 Hz; Lloj “Low Harmonic” me THDi \leq 5–8%; mënyra kontrolli vector / V/f; mbrojtje nga mbingarkesa, qark i shkurtër, mbivoltazh & nënvoltazh; filtër EMC i</p>		
--	--	--	--	--

		<p>integruar; komunikim Modbus/Profibus/Profinet (sipas projektit); montim në panel IP54 / kabinet metalik; klasë efikasiteti e lartë $\geq 97\%$</p> <p>V. Low Harmonic VFD Drive 350 kW; Tension furnizimi 690 V, 3~ 50 Hz; “Low Harmonic” me filtër harmonik; THDi $\leq 5-8\%$; kontroll vector / V/f; mbrojtje termike e motorit (PTC/NTC input); komunikim industrial (p.sh. Modbus RTU/TCP); ekran lokal me parametra; gradë mbrojtjeje min. IP64(ose në kabinet IP54).</p> <p>V. Low Voltage Panel – sipas skemës LVS03-03-01; Panel tensioni të ulët për shpërndarje dhe mbrojtje; nivel tensioni 400 V; busbar bakri, dimensionuar për rrymë pune sipas skemës ; rezistencë ndaj qarkut të shkurtër min. 50 kA / 1 s; formë ndarjeje min. Form 2b ose më lart sipas IEC 61439; strukturë metalike me bojë elektrostatische; gradë mbrojtjeje IP31–IP54; përmban MCCB/ACB, kontaktorë, relé mbrojtjeje, terminale, etj., sipas LVS03-03-01</p> <p>V. TPS1 Control Panel – PLC Control; Panel kontrolli për stacionin TPS1; përmban PLC CPU, module DI/DO/AI/AO (rezervë min. 20%); furnizim 24 VDC; terminale për gjithë sinjalet nga/tek fusha; UPS industrial për PLC & komunikim; qarkë mbrojtjeje (MCB, rele termike); gradë mbrojtjeje IP54; ventilim me filter fan; drita dhe prizë</p>		
--	--	--	--	--

		<p>shërbimi; etiketim i plotë i dukshëm; ndërtim sipas standardeve IEC 60204 & 61439.</p> <p>V. TPS2 Control Panel – PLC Control; Panel kontrolli për stacionin TPS2; konfigurim i ngjashëm me TPS1; PLC me memorje dhe shpejtësi të mjaftueshme; I/O dimensionuar për pajisjet e fushës; portë komunikimi Ethernet/RS485; UPS për të paktën 30 minuta ne punë; terminale shërbimi, mbrojtje ndaj rrymave tranzitore; IP54; dokumentacion elektrik (drafte, lista kabllorsh, BOM).</p> <p>V. Chlorination PLC Control Panel Panel i dedikuar për sistemin e klorinimit; PLC me I/O për kontrollin e pompave dozimet, valvulave, niveleve dhe matësit e rrjedhës; hyrje për sensorë Cl₂, pH, ORP etj. (sipas projektit); furnizim 400/230 V dhe 24 VDC; mbrojtje e veçantë kundër korrozionit (bojë speciale, ventilim i filtruar); gradë mbrojtjeje IP54/IP65; sinjalizime LED & alarm “common fault”; bornierë e qartë për integrim me SCADA.</p> <p>V. e sensoreve te presionit perfshire kabllimin -1 deri ne 1.5 Bar</p> <p>V. e sensoreve te presionit perfshire 0-25 me dy celesa min dhe max</p> <p>V. e sensoreve te nyjes se shurjes te grushtit hidraulik 0-25 Bar</p> <p>V. radio transmetim sistem nga PST te RS2</p>		
--	--	--	--	--

		Instalimi i sensoreve te nivelit ultrasonik qe jane furnizuar nga nje furnitor tjetër		
NS-13- A	Impiante dhe linja telefonike dhe telekomunikacioni	V. SCADA Server Server industrial / rackmount; CPU quad-core ose më i lartë; RAM ≥ 16–32 GB; SSD ≥ 512 GB + HDD arkivimi; redundancë e furnizimit me energji (dual PSU) sipas kërkesës; 2× karta rrjeti Gigabit për LAN dhe rrjetin e automacionit; OS licencuar (p.sh. Windows Server); mundësi backup-i automatik dhe antivirus industrial; konfigurim për punë 24/7. V. UPS monofaze 230 V me kapacitet 4 kVA me kohe mbajtje minimumi 4 ore per serverat e SCADA Sistemit Çmontimi i mimik panel dhe zevendesimi i tij me nje Ekarn 70 " duke perfshire lidhjen e tij me sistemi SCADA V. PC komplet me aksesor dhe 2 monitor;tastierë dhe mouse , dhe elementet ne UKK sipas SCADA Arkitekture	0-20ml leke	1 673 676
NS-14-A	Klasifikim A – Impiante te brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.	F.V.Kabllo 24 kV 3x35mm2 XLPE perfshire dhe mufet bashkuese sipas kerkeses gjate shtrirjes ne terren, duke perfshire hapjen e kanalit, shtrimi, reren, tullen, shiritn si dhe kalimin ne dy urat 15m dhe 45 m me metoden e varjes te futur ne tub mbrojtes celiku sipas specifikimeve me te gjithë zerat F.V.Kablli optik 1 x 8 i futur ne tub HDPE OD 40 per puset PS504 dhe PS 505 duke perfshire kanaln F.V.Kablli optik 1 x 8 i futur ne tub HDPE OD 40 per	0-20 milion	11,735,760

		<p>puset PS501 dhe PS 502 duke perfshire kanalin F.V.Koka Kablli 24 kV 3x35mm² XLPE Çmontimi i pajisjeve te TM dhe i transformatorit te PS 504 dhe PS505 dhe largimi i tyre ne vendin e caktuar nga UKRK Sh.a. V. Ndares Hyres TM 10-30 kV Tipi IM V. Ndares 10-30 kV per transformatorin me siguresse, Tipi QM V. Ndares Dalje 10-30 kV per lidhjen e PS 504 me PS505 , tipi IM Trn-03-00-02 V. Transformator fuqie me vaj per Puset 504 dhe 505 20/10/0.4 kV 100 kVA Vcc = 6% V. Panel i TU per puset 501 dhe 502 me pompe 37 kW Panel kontrolli për stacionin PS501 dhe 502 ; përmban PLC CPU, HMI, module DI/DO/AI/AO (rezervë min. 20%); furnizim 24 VDC; terminale për gjithë sinjalet nga/tek fusha; UPS industrial me 4 ore, për PLC & komunikim; qarkë mbrojtjeje (MCB, rele termike); gradë mbrojtjeje IP54; ventilim me filter fan; drita dhe prizë shërbimi; etiketim i plotë i dukshëm; ndërtim sipas standardeve IEC 60204 & 61439. Ne kete panel duhet te merret parasysh qe do te instalohet VFD i cili eshte ne gjendje ne cdo pus V. Panel i TU per puset 504 dhe 505 me pompe 55 kW Panel kontrolli për stacionin PS504 dhe 505; përmban PLC</p>		
--	--	---	--	--

		<p>CPU, HMI,module DI/DO/AI/AO (rezervë min. 20%); furnizim 24 VDC; terminale për gjithë sinjalet nga/tek fusha; UPS industrial me 4 ore, për PLC & komunikim; qarkë mbrojtjeje (MCB, rele termike); gradë mbrojtjeje IP54; ventilim me filter fan; drita dhe prizë shërbimi; etiketim i plotë i dukshëm; ndërtim sipas standardeve IEC 60204 & 61439. Ne kete panel duhet te merret parasysh qe do te instalohet VFD i cili eshte ne gjendje ne cdo pus V. e Sensoreve te presionit 0-25 Bar sipas specifikimeve "V. e matesit te prurjes te tipit elektromagnetik DN200 PN 16 sipas specifikimeve"</p>		
--	--	---	--	--

2.2.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- a. **1 (një) Inxhinier Elektrik**
- b. **1 (një) Inxhinier Mekanik**
- c. **1 (një) Inxhinier Elektronik**

Për secilin inxhinier drejtues teknik duhet të paraqiten:

- Kontratë individuale pune e vlefshme.
- Diploma e arsimit të lartë/licenca.
- Listëpagesat e shoqërisë për të paktën tre muajt e fundit në të cilat inxhinierët e sipërpërmendur duhet të figurojnë.
- Dëshmi kualifikimi për sigurimin Teknik.
- Listëpagesat e shoqërisë për të paktën për tre muajt e fundit: Janar, shkurt, Mars 2026, në të cilat inxhinierët drejtues teknikë të sipërpërmendur duhet të figurojnë.

Shënim: Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e inxhinierëve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

R. Rrezhda

V. Lubonja

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues, për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, të kërkuar për këtë pikë.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe ne Ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates dhe zërat e punimeve. Nevoja për 1 (një) Inxhinier Elektrik , 1 (një) Inxhinier Mekanik, si dhe 1 (një) Inxhinier Elektronik, në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit.

Punimet apo veprimtaritë për të cilat kërkohet ekspertiza profesionale e inxhinierëve drejtues janë:

1 (një) Inxhinier Elektrik	Zbatimi i skemave elektrike , çmontim – instalim i paisjeve elektrike, lidhjen elektrike të paisjeve të ndryshme (Transformator, Fidrat , Inverterat etj.) , testimin e paisjeve dhe mbrojtien e tyre.
1 (një) Inxhinier Mekanik	Çmontim dhe furnizim instalim të elektropompave, valvulave, saraqineskave dhe përshtatja e bazamenteve të paisjeve.
1 (një) Inxhinier Elektronik	Instalimin e sistemit programimit plc , strukturën e scada , komunikimin në distance të paisjeve elektronike dhe elektrike rrjetin ethernet, testimin e paisjeve dhe mbrojtien e tyre. Siguria kirbenetike e sistemit, modemmat shperndaresat e internetit mos kenë ndërhyrje të jashtme të cilat mund të çojnë në çorjentimin e sistemit SCADA.

(Shënim- argumentoni nevojën për stafin e kërkuar, duke specifikuar punimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale, argumentimin mbi kërkesat dokumentare për disponimin e këtij stafi, si dhe për llojin e licencës/certifikatës/kualifikimit të kërkuar për secilin prej tyre, nëse është rasti, duke specifikuar edhe aktin ligjor apo nënligjor konkret, ku parashikohet nevoja për licencimin apo certifikimin e tyre).

2.2.4 Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- 2 (dy) Inxhinierë Elektrik me profil Automatizimi industrie, ku të paktën njëri prej tyre të jetë certifikuar për:
R. Rrezhda

V. Lubonja

- Software programimi PLC dhe SCADA
- Profesionist Rrjeti Nderjmarrje i Sigurisë Kibernetike
- Specialist Ndermarrjeje i Sigurisë Kibernetike
- Specialist për invertera .

Për secilin inxhinier duhet të paraqiten:

- Kontratë individuale pune e vlefshme.
- Diploma përkatëse.
- Çertifikata/licenca përkatëse.
- Listëpagesat e shoqërise për të paktën për tre muajt e fundit: Janar, shkurt, Mars 2026, në të cilat specialistët e sipërpërmendur duhet të figurojnë.

Shënim: Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e inxhinierëve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues, për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, të kërkuar për këtë pikë.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe ne Ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht:

Kriteri për stafin mbështetës të kualifikuar, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates dhe zërat e punimeve. Nevoja për 2 (dy) Inxhinierë Elektrik me profil Automatizimi industrie është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit.

Punimet apo veprimtaritë për të cilat kërkohet ekspertiza profesionale e inxhinierëve jane:

1 (nje) Inxhinierë Elektrik me profil Automatizimi industrie	Çmonitm dhe instalim te paisjeve elektrike elektronike në puset, PZ2 dhe depot.
	Çinstalim ekzistues dhe instalim i sistemit programimit plc , strukturës scada , komunikimi në distancë i paisjeve elektronike dhe elektrike rrjetit ethernet.Konfigurimi i PLC me inverterat ,

<p>1 (nje) Inxhinierë Elektrik me profil Automatizimi industrie, i çertifikuar për:</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Software programimi PLC dhe SCADA ○ Profesionist Rrjeti Nderjmarrje i Sigurisë Kibernetike ○ Specialist Ndermarrjeje i Sigurisë Kibernetike ○ Specialist për invertera 	<p>fidrat dhe te gjithë senoret e komunikimit me sinjal analog , dixhital , modbas dhe ethernet.</p> <p>Siguria kirbenetike e sistemit, modemmat shperndaresat e internetit mos kenë ndërhyrje të jashtme të cilat mund të çojnë në çorjentimin e sistemit SCADA.</p>
---	---

(Shënim- argumentoni nevojën për stafin e kërkuar, duke specifikuar punimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale, argumentimin mbi kërkesat dokumentare për disponimin e këtij stafi, si dhe për llojin e licencës/certifikatës/kualifikimit të kërkuar për secilin prej tyre, nëse është rasti, duke specifikuar edhe aktin ligjor apo nënligjor konkret, ku parashikohet nevoja për licencimin apo certifikimin e tyre).

2.2.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/ të kualifikuar**, minimumi si më poshtë:

- a. 4 (katër) Specialistë Elektricistë
- b. 2 (dy) Specialistë mekanikë
- c. 1 (nje) shofer kamioni vinç
- d. 1 (nje) Manovrator minieskavatori
- e. 2 (dy) punëtorë krahu

Për secilin specialist duhet të paraqiten:

- Kontratë individuale pune e vlefshme.
- Diploma/certifikata përkatëse të arsimit profesional, që vërteton nivelin e kualifikimit profesional, lëshuar nga institucione publike/private, të licencuara/akredituara, te njohur nga Republika e Shqipërisë, sipas Ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” ose ekuivalente.
- Dëshmi kualifikimi për sigurimin Teknik
- Listëpagesat e shoqërisë për të paktën për tre muajt e fundit: Janar, shkurt, Mars 2026, në të cilat specialistët e sipërpërmendur duhet të figurojnë.

Për drejtuesit e mjeteve shoferin dhe manovratorin , kur mjetet disponohen me qira drejtuesit e mjeteve shoferin dhe manovratorin, **operatori ekonomik mund ta disponojë edhe nëpërmjet kontraktimit**, së bashku me mjetet e mara me qira, pa pasur nevojë të jenë të përfshirë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues.

R. Rrezhda

V. Lubonja

Sqarojmë se për 2 punëtorët e krahut duhet të paraqiten vetëm kontratat e punës të vlefshme.

Shenim: Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e stafit teknik në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar për këtë pike.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe në Ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Bazohet në përcaktimin ligjor që kritret duhet të jenë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Është vendosur kërkesa për disponimin e 4 Elektricitëve, të cilët do të shërbejnë për çinstalim ekzistues dhe instalimin e paisjeve elektrike dhe elektronike në bazë të projektit që do të zbatohet inxhinierët elektrik dhe elektronik. Kjo kërkesë përputhet me natyrën e kontratës dhe punimet e parashikuara.

Është vendosur kërkesa për disponimin e 2 Mekanikëve, të cilët do të shërbejnë për çinstalim ekzistues dhe instalimin e elektropompave, valvulave, sarqaqineskave dhe në strukturimin e bazamenteve të paisjeve elektrike, në bazë të projektit që do të zbatohet inxhinieri mekanik. Kjo kërkesë përputhet me natyrën e kontratës dhe punimet e parashikuara.

Është vendosur kërkesa për disponimin e 1 shoferi kamioni vinc i cili do të shërbejë për transport e paisjeve me autovinc.

Është vendosur kërkesa për disponimin e 1 Manovrator eskavatori, i cili do të shërbejë për drejtimin e Minieskavatorit, hapje dhe mbulim të shtrimit të rrjetit të tensionit të mesëm 10-20kV nga stacioni në puse dhe në gjurmime që do realizohen nga furnizuesi OSHE deri në lidhjen e tensionit 10-20kV në fidrat. Kjo kërkesë përputhet pra me natyrën e kontratës dhe punimet e parashikuara.

Është vendosur kërkesa për disponimin e 2 punëtorëve të krahut, për punë të ndryshme krahu gjatë realizimit të projektit si psh. në nivelimin e kanalit të rrjetit elektrik, sistemimin e fibrës e shtrimit të fibrës optike etj.

R. Rrezhda

V. Lubonja

2.2.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 15 persona**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Shënim: Për këtë pikë operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e VETËDEKLARIMIT sipas shtojcës nr.8.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorezojë pranë AK **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Dokumentacioni provues për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, që operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë dokumentat provues :

Listpagesat e sigurimeve shoqërore të konfirmuara nga organet tatimore, për periudhën kohore, tre muajt : Janar, Shkurt, Mars 2026 për punësimin e mesatarisht 15 persona.

Argumentimi: Përcaktimi i numrit të punonjësve bazohet tek Ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore dhe tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës etj.. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje : Janar, Shkurt, Mars 2026 tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës.

Numri i punonjësve të kërkuar është vendosur minimalisht : 15 persona sipas kriterëve më sipër:
3 Inxhinier Elektrik + 1 Inxhinier Mekanik+ 1 Inxhinier Elektronik + 4 Specialistë
Elektracistë + 2 Specialistë mekanikë + 1 shofer kamioni vinç + 1 Manovrator minieskavatori +
2 punëtorë krahu = 15.

Periudha kohore e listpagesave të sigurimeve shoqërore është përcaktuar periudha : Janar, Shkurt, Mars 2026 , në mënyrë që kriteri të përfshijë një periudhë sa më koherente.

Vlerësohet domosdoshmëria e stafit të punësuar për një periudhë të mëparshme, periudhën: Janar, Shkurt, Mars 2026 duke argumentuar se kjo shërben si tregues i një marrëdhënie të besueshme e të qëndrueshme midis punëdhënësit e punëmarrësit.

R. Rrezhda

V. Lubonja

2.2.7 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës:

Nr.	Lloji i Makinerive / Pajisjeve	Statusi	Sasia
1	Autovinc min 10 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
2	Minieskavator	në pronësi ose me qira	Copë 1
3	Automjet teknik për transport pajisjesh dhe ekipeve në terren	në pronësi ose me qira	Copë 1
4	Kamera inspektimi termografike	në pronësi ose me qira	Copë 1
5	Testues për instalime (Multifunksional Installation Tester) Perfshirë RCB	në pronësi ose me qira	Copë 1
6	Laptop ose stacion programim	në pronësi ose me qira	Copë 1
7	Licenca për software dhe programim të pajisjeve (SCADA, HMI, PLC)	në pronësi ose me qira	Copë 1

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që verteton pronësinë e mjetit: -leja e qarkullimit; -çertifikatën e kontrollit teknik; siguracionin dhe fotot perkatese;
- Ndersa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirase e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore perkatese, fotot, ndersa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirase e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

Autoriteti kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë, në çdo kohë, deri në përfundimin e kontratës mjetet dhe pajisjet teknike të deklaruara nga operatori ekonomik.

Shenim: Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e mjeteve dhe pajisjeve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.

Ndersa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar për këtë pike.

R. Rrezhda

V. Lubonja

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore , me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Lloji dhe sasia e makinerive të kërkuara është përcaktuar në raport (në përpjestim) me punimet konkrete që do të kryhen, volumet e tyre dhe grafikun e punimeve.

(Shënim: përcaktoni aktin ligjor apo nënligjor, në bazë të të cilit është bërë përlllogaritja teknike e numrit të punonjësve dhe mjetet/makineritë/pajisjet e nevojshme për zbatimin e kontratës)

2.2.8 Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizma ndërkombëtarë akreditues, **ose Çertifikata ekuivalente të njohura nga organizmi kombëtar i akreditimit i njohur nga Republika e Shqipërisë**, si më poshtë:

- ISO 9001:2015 – Sistemet e Menaxhimit te Cilesise ose ekuivalent
- ISO 14001:2015 – Sistemi i Menaxhimit Mjedisor ose ekuivalent
- ISO 45001:2018 – Sistemet e Menaxhimit te Shendetit dhe Sigurise ne Pune ose ekuivalent
- ISO/IEC 27001:2022 – Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit dhe Sigurisë Kibernetike ose ekuivalent

Shënim: Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, secili anëtar i bashkimit duhet të plotësojë kriterin në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.Për vetë natyrën e veçantë, vendndodhjen dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rendësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësië, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.

R. Rrezhda

V. Lubonja

Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë për Sistemin e menaxhimit të cilësisë ISO 9001 (e vlefshme) për të garantuar kërkesat cilësore të materialeve të ndërtimit dhe punimeve të zbatimit.

Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë për Sistemin e menaxhimit të mjedisit ISO 14001 (e vlefshme) për të garantuar rehabilitimin e plotë të sheshit të ndërtimit gjatë dhe pas kryerjes së punimeve me ndikime sa më të vogla në mjedis.

Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë për Sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë ISO 45001-2018 për të garantuar sigurinë e punëtorëve të zbatimit gjatë kryerjes së punimeve.

Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë ISO/IEC 27001:2022 – Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit dhe Sigurisë Kibernetike ose Çertifikatën ekuivalente të njohur nga organizmi kombëtar i akreditimit i njohur nga Republika e Shqipërisë për të siguruar menaxhimin e sigurisë të informacionit e cilësisë të punëve që kërkohen dhe lidhen me sistemet e teknologjisë së informacionit. Ky lloj çertifikimi siguron që OE ka të implementuar një sistem menaxhimi të Sigurisë së Informacionit dhe Sigurisë Kibernetike për punën e ofruar. Nevojitet që siguria kibernetike e sistemit, modemat shperndaresat e internetit mos kenë ndërhyrje të jashtme të cilat mund të çojnë në çorjentimin e sistemit SCADA.

2.2.9 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose autorizim nga distributori i autorizuar për pajisjet/mallrat transformatorë, fidër, invertera, SCADA, elektropompa dhe valvulat pjesë e objektit të prokurimit.

Në rast paraqitje të autorizimit nga distributori, OE duhet të paraqesë:

dokumentacion për të vërtetuar lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar, pra për të vërtetuar se subjekti në fjalë është distributor zyrtar .

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, e nevojshme kjo për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm që garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek Autoriteti Kontraktor të pajisjeve/mallrave: transformatorë, fidër, invertera, SCADA, elektropompa dhe valvulat. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të pajisjeve/mallrave: që kërkohen , që janë prodhuar në përputhje me standarde të përshtatshme cilësie. Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës, lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e operatorit ekonomik ofertues për aftësitë teknike dhe i shërben autoritetit

R. Rrezhda

V. Lubonja

kontraktor për njohjen e mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe nenin 39 të VKM- së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

2.2.10 Për të dëshmuar se i plotësojnë kërkesat teknike të përcaktuara në DT , operatorët ekonomikë duhet të paraqesin katalogë /skede teknike, për pajisjet/mallrat: transformatorë, fidër, invertera, SCADA, elektropompa dhe valvulat që janë pjesë e objektit të prokurimit, ku të tregohen qartë se karakteristikat teknike të pajisjeve/materialeve, janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Në katalogun/et/skedat e paraqitura të shënohen në mënyrë të dukshme modeli i pajisjes/mallrave të ofruar, së bashku me specifikimet teknike të kërkuara nga AK.

Pjesët specifike të katalogut/skedës teknike, ku jepen karakteristikat teknike nqs nuk janë në gjuhën shqipe të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur nga ana e AK në zbatim të kërkesave që përcakton ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” me ndryshime, si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” me ndryshime.

Plotësimi i këtij kriteri garanton ekzekutimin e objektit të kontratës në përputhje me specifikimet teknike të DT.

Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

R. Rrezhda

V. Lubonja

- Operatori ekonomik që do të kryejë ekzekutimin e punëve duhet të paraqesë:
 - çertifikatat e prodhuesit e markimit CE/SSH për pajisjet/mallra : transformatorë, fidër, invertera, SCADA, elektropompa dhe valvulat , që vërtetojnë përputhjen me specifikimet teknike të kërkuara, si dhe vërtetojnë se prodhuesi i këtyre pajisjeve/mallrave është në përputhje me kërkesat e sigurisë sipas standardeve Europiane dhe Shqiptare, standarde këto të përcaktuara në specifikimet teknike.
 - Fletë garanci me afat minimal 10 vjet për pajisjet/mallrat: transformatorë, invertera, elektropompa, SCADA dhe elementët e saj.
 - Manualet e përdorimit të pajisjeve/mallrave ne gjuhe angleze.
 - Garancia e punimeve: 2 vjet.

Bashkangjitur paraqitet Projekti i zbatimit.

Bashkangjitur paraqitet Preventivi i punimeve.

Bashkangjitur paraqiten specifikimet teknike për zbatimin e projektit.

Bashkangjitur paraqitet Grafikut i zbatimit të punimeve.

R. Rrezhda

V. Lubonja